

VENDIM
Nr. 483, datë 24.7.2024

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 322, DATË 31.5.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE DHE PUNONJËSVE ADMINISTRATIVË NË AGJENCINË SHETETËRORE TË KADASTRËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, dhe të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 322, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës së pagës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve dhe punonjësve administrativë në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas pikës 5 shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:

“5/1. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar institucioni”, në Drejtorinë e Pronës Shtetërore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, janë sipas lidhjes nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”;

b) Në lidhjen nr. 1, emërtesa “Drejtore njësie” shfuqizohet;

c) Lidhja nr. 2 “Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar institucioni”, në drejtoritë vendore dhe zyrat vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës” zëvendësohet me lidhjen nr. 2 me të njëjtin emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2024, fillojnë nga momenti i emërimit/transferimit të nëpunësve në detyrë dhe përballohen nga buxheti i miratuar për Agjencinë Shtetërore të Kadastrës për vitin 2024, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Lidhja nr. 2

Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar institucioni”, në drejtoritë vendore dhe zyrat vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës

Pozicioni	Klasa e pagës	Grupi i diplomës	Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune)
Titullar i drejtorive vendore	III-1	1	20 000
Zëvendëstitullar i drejtorive vendore	III-2	1	18 000
Përgjegjës sektori në drejtoritë vendore	IV-1	1	18 000
Specialist në drejtoritë vendore	IV-2	1	18 000
Titullar i zyrës vendore	III-3	1	18 000

Specialist në zyrat vendore	IV-3	1	18 000
-----------------------------	------	---	--------

Drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës janë:

Berat; Dibër; Durrës–Kavajë–Krujë; Elbasan; Fier; Gjirokastrë; Kamzë–Vorë; Korçë–Devoll–Kolonjë; Kukës; Lezhë; Lushnjë; Pogradec; Qendra e Kadastrës Digjitale; Sarandë; Shkodër; Tiranë Veri; Tiranë Jug; Tiranë Rurale 1; Tiranë Rurale 2; Vlorë; zonat e simuluar.

Zyrat vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (sipas rendit alfabetik) janë:

Bulqizë; Malësi e Madhe; Mat.

Lidhja nr. 3

Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “Titullar”, në Drejtorinë e Pronës Shtetërore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës

Pozicioni	Klasa e pagës	Grupi i diplomës	Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune)
Titullar	I-4	1	20 000
Zëvendëstitullar	II-2	1	20 000
Përgjegjës sektori përmbajtjeje	III-1	1	18 000
Përgjegjës sektori mbështetës	III-2	1	18 000
Specialist	IV-1	1 ose 2	18 000
	IV-2	1 ose 2 ose 3	